



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:008644
Datë: 17.10.2018
Numri i dokumentit: 00148435

P.nr.1967/17

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhrete Sopaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarëve L. N. nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën.par. 1.4 të KP-së, M. G. nga Prizreni për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 199 par. 2 lidhur me par. 1 nën.par. 1.4 të KP –së dhe Sh. G. nga Prizreni për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par. 1 të KP -së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.140/17-I, të datës 18.10. 2017, më datë 08.10.2018, në prezencën e prokurorit Fatos Ajvazi, të akuzuarit M. G. dhe mbrojtësëve B. Gj., B. K. dhe G. Gj. e në mungesë të akuzuarve L. N. dhe Sh. G., publikisht mori dhe shpalli këtë

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit;

L. N., nga i ati H., dhe e ëma A., i lindur më datën *data e lindjes...*, në Prizren ku edhe tani banon në rr. ... nr..., ka të kryer arsimin fillor, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës me nr. të ID *numri personal...*

M. G., nga i ati N., dhe e ëma N., i lindur më datën *data e lindjes...*, në fashtin B. komuna e Prizrenit, tani banon në Prizren në rr. ... nr..., ka të kryer arsimin fillor, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës me nr. të ID *numri personal....*

Sh. G., nga i ati M., dhe e ëma A., i lindur më datën *data e lindjes...*, në Prizren ku edhe tani banon në rr. ... nr..., ka të kryer arsimin e mesëm, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, fasader, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës me nr. të ID *numri personal....*

I akuzuari **L. N.**;

Në bazë të nenit 364 par. 1 të KPP -së dhe nenit 12 të KP -së

LIROHET NGA AKUZA

I. Se më datë 31.08.2017 rreth orës 11:00 në Prizren në rr. ... i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje paraprake në mes të pandehurit L. dhe të pandehurit Sh. G., në lidhje me një konflikt të mëhershëm, i pandehuri e sulmon fizikisht të pandehurin Sh. G. duke e goditur me thikë në pjesën e pasme të regjionit të krahërorit me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: plagë prerëse shpuese në krahëror dhe supin e djathtë, lëndime këto të përshkruara në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekoligjor të dt. 27.09.2017

Me të cilën kishte për të kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me par. 1 nën.par. 1.4, për shkak se vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale, ngase është kryer në rrethanat e mbrojtjes së nevojshme.

I akuzuari **M. G.**;

Në bazë të nenit 365 të KPP -së

ËSHTË FAJTOR

II. Se më datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje paraprake në mes të pandehurit dhe të pandehurit L. N., në lidhje me një konflikt të mëhershëm, i pandehuri e sulmon fizikisht të pandehurin L. N. duke e goditur me kaçavidë në këmbën e djathtë dhe në shpatullën e maj me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: plagë prerëse shpuese në kofshën e djathtë dhe shpatullën e majtë, lëndime këto të përshkruara në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekoligjor të dt. 27.09.2017

Këshu që ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën.par. 1.4 të KP –së.

I akuzuari **Sh. G.**;

Në bazë të nenit 365 të KPP -së

ËSHTË FAJTOR

III. Se më datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, me dashje përdor forcën ndaj personave tjerë, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje paraprake në mes të pandehurit Sh. dhe të pandehurit L. N., në lidhje me një konflikt të mëhershëm, i pandehuri e sulmon fizikisht të pandehurin L. N. duke e shtyer me dy duar në gjoks.

Kështu që ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 1 të KP –së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 6, 7,17, 41, 42, 45, 46, 73 KP-së,

Të akuzuarit **M. G.** i'a shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin denim do ta vuan pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykim.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 31.08.2018 deri më dt. 30.11.2017 do t'i llogaritet në denimin e shqiptuar.

Në bazë të nenit 69 të KP të akuzuarit i shqiptohet edhe

DËNIMI PLOTËSUES

I konfiskohet një kaçavidë me gjatësi prej 11.5 cm, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Të akuzuarit **Sh. G.** i'a shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin denim do ta vuan pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykim.

Obligohet i akuzuari M. G. që t'i paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të jenë ato sipas llogarisë së arkës së kësaj gjykate, dhe ne emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej nga 30 (tridhjetë) €, për ekspertizën mjekoligjore shumën prej 20 euro si dhe për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari Sh. G. që t'i paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të jenë ato sipas llogarisë së arkës së kësaj gjykate, dhe ne emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej nga 30 (tridhjetë) €, për kompenzimin e mëditjeve të ekspertit mjekoligjor shumën prej 50 euro si dhe për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren në këtë Gjykatë, ka parashtruar aktakuzë PP.nr.140/17-I, dt.18.10.2017, ndaj të akuzuarëve L. N., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.4 të KP -së, M. G. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën.par. 1.4 dhe Sh. G. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 187 par. 1 të KP –së..

Gjykata më datën 08.10.2018 ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në prezencë e të gjitha palëve.

Prokurori i shtetit M. G. gjykatës ja ka parashtruar me shkrim fjalën përfundimtare dhe ka deklaruar se mbesë në tërësi si në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, duke kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të denohen në bazë të ligjit, **(me gjerësisht shih fjalën përfundimtare me shkrim).**

Mbrojtësi i të akuzuarit L. N. av. B. K. fjalën përfundimtare gjykatës ja ka dorëzuar me shkrim dhe ndër tjerash ka propozuar që i akuzuari L. N. të lirohet nga akuza pasi që veprën e ka kyerer nën mbrojtjen e nevojshme, **(me gjerësisht shih fjalën përfundimtare me shkrim).**

I akuzuar L. N. është pajtuar me fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim gjykatës nga mbrojtësi i tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. G. av. B. Gj. nga Prizeni në fjalën përfundimtare e ka parashtruar me shkrim dhe e ka elaboruar duke deklaruar se: lidhur me akuzën në fjalë janë administruar të gjitha provat e mundshme për të cilat prokurori i shtetit ashtu edhe si mbrojtës i M. G. kemi gjetur se janë në interes të zhvillohet dhe vërtetohet gjendja e sakë faktike por të analizojmë dispozitivin e akuzës duke u mbështetur në provat materiale që janë nxjerrë dhe gjatë shqyrtimeve, konsideroj se me asnjë provë nuk vërtetohet se M. G. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, i mbrojturi im ka deklaruar se në ditën kritike ishte takuar me djalin e tij Sh. G. të cilit edhe i'a ka marr të hollat për Festën e Bajramit në atë çast i njëjti ka parë këtu të akuzuarin L. N., dhe i njëjti kur e ka parë që është sulmuar djali i tij ka vepruar në afekt mendor dhe i tronditur ku edhe sulmi të cilin e ka marr M. ka qenë joproporcional me të akuzuarin, andaj në fund propozoj që gjyqtari të shqipton aktgjykim lirues ndaj të mbrojturit tim M. G..

I akuzuari M. G. është pajtuar me deklaratën e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. G. av. G. Gj. nga Prizeni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: konsiderojmë që gjatë këtyre shqyrtimeve të mbajtura gjyqësore rreth administrimit të fakteve dhe provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarëve pamëdyshje këtu aktakuza ka dështuar ta vërtetoj përgjegjësinë penale të mbrojturit tim Sh. G.. Këtu si mungesë të vërtetimit të fakteve relevante në pyetjet: Sh. G. a ka mbajtur thikë-mjet të mbretë përgjigja është jo dhe kjo nuk mund të kontestohet, kështu që Sh. G. nuk ka mundur t'i shkaktoj lëndime trupore këtu të akuzuarit tjetër L. N., pra me çka ka mundur t'i shkaktoj lëndimet ku nga raporti i mjekut në mendimin e dhënë për lëndimet e të akuzuarit L. N., shaktimin e plagëve e nxjerr si rezultat i shkaktimit nga një mjet i mprehtë me çka konkludoj që i akuzuari Sh. G. nuk ka qenë akter i shkaktimit të lëndimit trupor që ka pësuar i akuzuari L. N., gjë që për këtë janë pamjet filmike në CD, ku Sh. G. me asgjë dhe me asnjë rrethanë nuk mund të provohet se ai është shkaktar i atyre lëndimeve. Pra edhe pse unë si mbrojtës thirrrem në mbrojtje të nevojshme i akuzuari L. duke përdorur thikën dhe duke e mbajtur, andaj Instituti juridik i mbrojtjes së nevojshme nuk mund të vlej për të gjithë të akuzuarit në mbrojtjen e tyre, kjo si: nuk kemi një natyrë të njëjtë të problemit, ka një tejkalim të mbrojtjes së nevojshme dhe sulmi nuk është i paraparë me proporcion me situatën e tillë dhe se mendoj se elementi i mbrojtjes së nevojshme-

mund të vlejë vetëm për të mbrojturin tim Sh. G., nëse do të mendohet me logjikën e arsyes juridike. Përfundimisht konsideroj se pas analizës së drejtë të fakteve dhe provave të

administruara në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari gjykues do të nxjerr aktgjykimin lirues për të mbrojturin tim Sh. G..

I akuzuari Sh. G. është pajtuar me deklaratën e mbrojtësit të tij.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit E. K., dhe në cilësinë e provës materiale ka shiquar, raportet mjekësore të Spitalit Rajonal të Prizrenit për të akuzuarit L. N. dhe Sh. G. të dt. 31.08.2017, ekspertizën mjekoligjore të dr. M. G., raportin e vendit të ngjarjes, listën e dëshmive dhe video-inqizimet që janë marrur nga vendi i ngjarjes (CD).

Dëshmitari E. K., ka deklaruar se: data, muaji dhe viti nuk më kujtohet, vetëm se e di se ka qenë paradite afërisht ka qenë ora 10-11.00 e paradites, kjo ka qenë te kthesa afër shkollës “Abdyl Frashëri” në Prizren, ne jemi nisur bashkë me të akuzuarin L. me dërguar motorrin për ta rregulluar te mjeshtri, ne kemi qenë në krah të djathtë të rrugës, duke e shtyrë motorrin veç kur kam parë personin këtu që është pak më i moshuar i pari ka dalur nga lokali, lokali ka qenë në anën e majtë të rrugës emrin e lokalit nuk ja di, i njëjti personi në fjalë ka pasur një kaçavidë në dorë, ndërkaq ka ardhur peroni tjetër pas tij djali i tij me kaçavidë në dorë, e kemi lëshuar motorrin dhe unë jam tërhekur nga aty jam larguar, pasi që unë jam larguar që të dy e kanë kapur L., L. pas kësaj ka filluar që të bërtas dhe kanë filluar që ta godasin në këmbë, ngajrjen e kam parë nga parapa, mandej unë nuk kam parë asgjë ngase kam shkuar në shtëpinë e L. për ta treguar rastin.

Nga leximi në raportet mjekësore të dt. 31.08.2017 në ditën kritike është vërtetuar fakti se të akuzuarit L. N. dhe Sh. G. kanë marrur ndihmën e parë si pasojë e përleshjes në në Emergjencën e Spitalit Rajonal të Prizrenit.

Nga leximi në ekspertizën mjekoligjore të dt. 27.09.2017 të dr. M. G. është vërtetuar fakti se të akuzuarit Sh. G. dhe L. N. kanë pësuar lëndimet trupore dhe sipas ekspertit mjekoligjor këto lëndime janë të natyrës së lehtë trupore me pasoja të përkoshme për shëndetin.

Është dëgjuar në cilësinë e ekspertit mjekoligjor edhe dr.M. G. nga Prishtina i cili është përgjigjur në pyetjet e palëve në procedurë në lidhje me lëndimet trupore që kanë pësuar të akuzuarit dhe i njëjti ndër tjerash ka deklaruar se: mendimin e tij e ka dhënë mbi bazën e raporteve mjekësore të marrura nga Spitali Rajonal në Prizren dhe sipas këtyre raporteve lëndimet janë kualifikuar si lëndime të lehta trupore, poqese do të kishte ndonjë raport tjetër mjekësor unë jam i gatshëm që ta plotësoj raportin tim.

Nga leximi në raportin e vendit të ngjarjes të dt. 31.08.2017 përshkruhet në mënyrë kronologjike rrjedha e punë teknike kriminalistike (veprimet e nëdërrmara) në vendin e ngjarjes nga tekniku i kriminalistikës.

Nga shqimi në listën e dëshmive përshkruhen dëshmit e gjetura në vendin e ngjarjes në ditën kritike: një (1) strisho - tampon pambuku me njollë të kuqe për të cilën dyshohet se është njollë gjaku, dëshm.1, Një (1) strisho -tampon pambuku me njollë të kuqe për të cilën dyshohet se –

është njollë gjaku dësh.2 dhe Një (1) kaçavidë me gjatësi 11.5cm njollë të kuqe për të cilën dyshohet se është njollë gjaku dëshm.6

Nga fotoalbumi i dt. 31.08.2017, shihen disa foto nga rr. ... vend -trotuari ku dyshohet se ka ndodhur rasti, gjurmët e gjakut dhe një motoçiklet e rrëzuar në trotuar, pamjet emergjencës dhe pamjet pantollonave të prera të L. N. dhe të maicës së prerë të Sh. G., pamjet e kaçavidës tek pjesa e motorit etj.

Nga shiqimi të videoinqizimet (CD) të siguruar nga policia dhe mbrojtësi i të akuzuarit L. av. B. K. në prani të palëve shihet se si ka filluar e tërë ngjarja në një moment i pandehuri L. shihet duke ikur vrapuar, e në drejtim të tij duke vrapuar shihet i akuzuari M., më pastaj dhe i akuzuari Sh., arrijnë që ta kapin të akuzuarin L. më pas të akuzuarit M. dhe Sh. e fusin në mes të akuzuarin L. dhe fillojnë që ta godasin, i akuzuari L. me një çantë duke e rrokullisur shihet se fillon që edhe ai ti godas të akuzuarit M. dhe Sh., pas disa sekonda i akuzuari L. arrin që të largohet nga të akuzuarit M. dhe Sh. dhe fillon të ik ndërkaq të akuzuarit M. dhe Sh. fillojnë ta ndjekin pas për disa sekonda dhe ndalen, i akuzuari L. ik dhe nuk shihet se ku shkon.

I akuzuari L. N. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se qëndroj në tërësi pranë deklaratave që kam dhënë në polici dhe prokurori duke shtuar se: ky rast ka afërsisht tri vjet dhe është nisur për dy fëmijë, por më tepër për një fqinjë tonin që rrin me të akuzuarin M. dhe Sh., pëderisa ata vazhdimisht luajshin me top para dyerve të mia dhe i dëmtonin veturat tona dhe të fqinjëve tjerë, pastaj fqinjët bënin ankesa te babai im dhe mandej një natë ja kam larguar topin para dyerve edhe ata kanë shkuar duke gënjyer kinse i kam fyer unë dhe i kam shrë, në ditën kritike kam qenë në shtëpi dhe kam pas një motorr defekt, e kam marr motorrin dhe kam vazhduar rrugën për të mjeshtri duke e shtyrë nga prapa ka ardhur M. G. me motorr të vetin, ka dal anash dhe ka nxjerr diçka nga motorri dhe e ka thirr djalin e vet Sh. G. cili ka qenë duke pirë kafe dhe pastaj më kanë sulmuar, jam tërhequr dy tri herë, por nuk kam mujt që të largohem më shumë se 200-300 metra, i pari më ka goditur M. dhe mandej jam futur në mes të dyve dhe skam mujtur më të vërej asgjë, që të dy më kanë goditur me kaçavidë (shtrafsiger) dhe më kanë goditur në anën e majtë të shpatullës lart dhe në këmbën e djathtë përpara, kam pasur një thikë më veti pasi që këtë e mbaj për arsye se të akuzuarit te dera më përcjellin dhe më ndjekin me kerr dhe më thikë e kam goditur Sh. duke u mbrojtur, fillimisht më ka goditur me kaçavidë M. pastaj ka arritur që tjetrën kaçavidë të ja jap Sh., pasta unë kam filluar që të iki dhe e kam parë veten të gjakosur, e kam nxjerrur thikën për ti friguar që ata të largohen ata vazhdimisht nuk janë ndalur, pastaj jam larguar dhe kam ikur, pas kësaj ngjarje kemi pasur edhe shumë provokime të tjera dhe para një muaji Sh. G. me automjet mua, vëllain tim dhe dy shokët e vëllait na ka goditur me veturë me dy motorra dhe kemi pësuar lëndime...

I akuzuari M. G. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë deklaratës ë dhënë në polici dhe prokurori duke shtuar se deklaratën që ka dhënë polici nuk është e saktë, në ditën kritike në atë moment kam qenë i humbur i tëri pasi që vuaj edhe nga sëmundja e zemrës, i pabdehuri L. në çantë ka pasur armë dhe patent-thikë dhe e kam parë që tri herë e ka goditur Sh. dhe pasi që djali im është gjakosur i tëri dhe në ikje e sipër, **“unë mund ta kem goditur L. me kaçavidë”**, unë kam pasur kaçavidën pasi që kam dalur me motorr mi marr të hollat për festëne Bajramit motorri më është prishur, ndërkaq i akuzuaru Sh. nuk ka pasur, djali im ka qenë duke ardhur në drejtim timin që të mi jap paret L. e ka gjuajtur motorrin dhe e ka haour çantën dhe ka nisur që të shaj dhe pas kësaj djali im ka vrapuar dhe e –

ka kapur të akuzuarin L., ky mandej e ka nxjerrur thikën revolën e mandej e ka kap thikën dhe djali e ka kapur për dore dhe sulmin ia ka nisur L..

I akuzuari Sh. G. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se: qëndroj në tërësi në deklaratën e dhënë në prokurori duke shtuar se kam qenë duke pirë kafe, e kam pritë një njeri që të mi bjen pare për

festë të Bajramit, pasi që unë punoj me fasadë, babai im ka ardhur që të mi marr paret, L. aty shante babin tim dhe L. filloi pas kësaj që të ikte dhe unë e ndoqa pas dhe pasi u ktheva i njëjti më goditi me thikë, unë nuk kam pasur asgjë **“është e vërtetë që e kam shtyrë të akuzuarin L. dhe i kam thënë ec”**, mandej nuk di asgjë së më ka humbur vetëdija...

Gjykata e liroj nga akuza të akuzuarin L. N. për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nën par. 1 nën.par. 1.4 të KP-së, pasi që veprën e ka kryer nën mbrojtjen e nevojshme në bazë të nenit 12 par. 1 të KP -së cekët se: “ Vepra penale e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale, ndërsa në par. 2 të këtij neni cekët se: mbrojta e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetës ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rezikut që paraqet sulmi dhe duke u bazuar në kët çështje faktike:

Nga dëshmia e dëshmitarit E. K., është vërtetuar se: *i akuzuri L. N. ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme pasi sipas dëshmitarit i cili ka qenë bashkë me të akuzuarin L. e kanë dërguar motorrin për ta rregulluar te mjeshtri, dhe aty diku te shkolla fillore “Abdyl Frashëri” në kthesë në krah të djathtë të rrugës, kanë qenë duke e shtyrë motorrin, dhe në atë moment ka parë personin të akuzuarin M. që i pari ka dalur nga lokali, lokali ka qenë në anën e majtë të rrugës me një kaçavidë në dorë, ndërkaq ka ardhur personi tjetër pas tij djali i tij me kaçavidë në dorë, e kemi lëshuar motorrin dhe unë jam tërhekur nga aty jam larguar, pasi që unë jam larguar që të dy e kanë kapur L., L. pas kësaj ka filluar që të bërtas dhe kanë filluar që ta godasin në këmbë, ngjarjen e kam parë nga prapa.*

Nga shiqimi i videoinqizimeve (CD) u vërtetua se: *të akuzuarit M. dhe Sh. fillojnë të parët që ta ndjekin të akuzuarin L., pra të parët sulmin e fillojnë të akuzuarit M. dhe Sh. G., sulmi ka qenë i atëçastshëm (aktual) pasi që është pritur që të filloj aty për aty pasi që të dy akuzuarit M. dhe Sh. G. kanë vrapuar në drejtim të akuzuarit L., dhe kanë filluar ta godasin të akuzuarin L. pasi që e kanë futur në mes. Pas kësaj i akuzuari L. në mbrojtje ka filluar që të godas të akuzuarit M. dhe Sh. duke e rrokullisur një çantë dhe me një mjet për të zbrapsur sulmin nga vetja duke i shkaktuar lëndime trupore të akuzuarit Sh. G., mbrojtja e të akuzuarit L. ka qenë proporcionale (përpjestueshmëri) me sulmin i cili zgjat disa sekonda, mbrojtja ka qenë e natyrës dhe intezitetit të tillë që është e mjaftueshme për të zbrapsur sulmin dhe i njëjti gjatë mbrojtjes ka përdorur mjete për mbrojtje në atë mënyrë që sulmuesve ti shkaktoj lëndime të lehta trupore e që janë në proporcion edhe me mjetin që ka përdorur i akuzuari M. dhe nga ky mjet ka përfituar lëndime të lehta trupore edhe i akuzuari L.. Mbrojtja e nevojshme në këtë rast do të ekzistonte edhe në rastet kur e keqja (dëmtimi) e shkaktuar me rastin e zbrapsjes së sulmit është më e madhe se e keqja që ka kërcënuar të shkaktohet nga sulmi e aq më tepër si sulmi ashtu edhe mbrojtja kanë qenë në ekuivalencë me njëra tjetrën dhe nuk kemi tejkallim të mbrojtjes së nevojshme, ngase mbrojtja ka qenë domosdoshmërisht e nevojshme për të zbrapsur sulmin e atëçastshëm dhe të kundërligjshëm. Në rastin konkret edhe pse pas përleshjes i akuzuari L. arrin të që të largohet dhe të ik dhe pushon se vepruari sulmi, të akuzuarit M. dhe Sh. fillojnë që ta ndjekin pas edhe për pak metra e mandej ndalen.*

Mbrojtësi i të akuzuarit M. G. av. B. Gj. në fjalën përfudimtare ndër tjerash ka deklaruar që i mbrojturi i tij kur e ka parë që është sulmuar djali i tij ka vepruar në afekt mendor dhe i tronditur ku edhe sulmi të cilin e ka marr M. ka qenë joproporcional me të akuzuarin.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. G. av. G. Gj. në fjalën përfundimtare ndër tjerash ka deklaruar se instituti i mbrojtjes së nevojshme nuk mund të vlej për të gjithë të akuzuarit në mbrojtjen e tyre pasi që nuk kemi një natyrë të njëjtë të problemit, ka një tejkallim të mbrojtjes së nevojshme dhe sulmi nuk është i paraparë në proporcion me situatën e tillë dhe se mendoj se se elementi i mbrojtjes së nevojshme mund

të vlej vetëm për të mbrojturi tim Sh. G. se Sh. G. nuk ka qenë akter i shkaktimit të lëndimeve trupore nga videonqizimet e shiquara, pra edhe unë si mbrojtës thirrrem në mbrojtje të nevojshme nëse do të mendohej me logjikën e arsye juridike, psi që i akuzuari L. ka përdorur thikën dhe e ka mbajtur. Gjykata konstaton se kjo nuk mund të çëndroj pasi që personi që vepron në mbrojtje të nevojshme nuk është e domosdoshme që të jetë dhe zakonisht nuk është gjithëherë në një gjendje aq të tronditur shpirtërore, e cila përjashton përgjegjësinë dhe fajësinë, për arsye se e drejta e mbrojtjes së nevojshme nuk njihet për shkak të tronditjes shpirtërore apo gjendjes afektive, por për shkak se konsiderohet që mbrojtja e këtyllë është e domosdoshme.

Gjykata në këtë rastë në tërësi i fali besimin dëshmisë së dëshmitarit E. K., dhe mbrojtjes së të akuzuarit L. N., kjo pasi që dëshmia e dëshmitarit dhe mbrojtja e të pandehurit ishin në përputhje të plotë edhe me provat e tjera, si që është video gjirimet të cilat janë prova të drejtpërdrejta në këtë rast.

Mbrojtësit e të akuzuarve M. G. dhe Sh. G. av. B. Gj. dhe G. Gj. në fjalën e tyre përfundimtare janë munduar që veprimet e të akuzuarit L. N. t'i konsideroj si tejkallim të mbrojtjes së nevojshme, dhe veprimet e të akuzuarve M. G. dhe Sh. G. të konsiderohen si mbrojtje e nevojshme, por gjykata pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve M. G. dhe Sh. G., nuk i mori si të provuara sepse këto pretendime nuk gjejnë mbështetje në provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësorë, andaj gjykata ka ardh në përfundim se pikërisht në veprimet e të akuzuarit L. N. përmbushën të gjitha elementet e mbrojtjes së nevojshme siç është Sulmi dhe Mbrojtja. Andaj këto ishin arsyet vendimtare që gjykata të akuzuarin L. N. e liroj nga akuzat, për shkak se i njëjti kishte vepruar në vetëmbrojtje.

Për të akuzuarit M. G. gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se më datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje paraprake në mes të pandehurit dhe të pandehurit L. N., në lidhje me një konflikt të mëhershëm, i pandehuri e sulmon fizikisht të pandehurin L. N. duke e goditur me kaçavidë në këmbën e djathtë dhe në shpatullën e maj me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: plagë prerëse shpuese në kofshën e djathtë dhe shpatullën e majtë, lëndime këto të përshkruara në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekoligjor të dt. 27.09.2017

Për të akuzuarin Sh. G. ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se më datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, me dashje përdor forcën ndaj personave tjerë, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje paraprake në mes të pandehurit dhe të pandehurit L. N., në lidhje me një konflikt të mëhershëm, i pandehuri e sulmon fizikisht të pandehurin L. N. duke e shtyer me dy duar në gjoks.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga dëshmitari E. K. dhe nga videonqizimet sipas dëshmitarit i cili ka qenë bashkë me të akuzuarin L. e kanë dërguar motorrin për ta rregulluar te mjeshtri, dhe aty diku te shkolla fillore "Abdyl Frashëri" në kthesë në krah të djathtë të rrugës, kanë qenë duke e shtyrë motorrin, dhe në atë moment ka parë personin të akuzuarin M. që i pari ka dalur nga lokali, lokali ka qenë në anën e majtë të rrugës me një kaçavidë në dorë, ndërkaq ka ardhur personi tjetër pas tij djali i tij me kaçavidë në dorë, e kemi lëshuar motorrin dhe unë jam tërhekur nga aty jam larguar, pasi që unë jam larguar që të dy e kanë kapur L., L. pas kësaj ka filluar që të bërtas dhe kanë filluar që ta godasin në këmbë,

ngajrjen e kam parë nga parapa. Nga videonqizimet e shihen të akuzuarit M. dhe Sh. duke e goditur të akuzuarin L., pra dëshmia e dëshmitarit E. K. përputhet edhe me videonqizimet, gjedja faktike është vërtetuar edhe nga provat tjera materiale nga raporti mjekësor i Emergjences për ndihmën e parë që ka marrë i akuzuari L. N. për lëndimet që ka pësuar, gjithashtu kjo vërtetohet edhe nga ekspertiza mjekoligjor të dr. M. G. i cili dhe është dëgjuar në cilësinë e ekspertit mjekoligjor ku ka konstatuar se lëndimet që ka pësuar i akuzuari L. kualifikohen si lëndime të lehta trupore me pasojë të përkoshëm për shëndetin, gjithashtu edhe nga raporti i vendit të ngjarjes dhe nga fotoalbumi përshkruhet gjendja nga vendi i ngjarjes si dhe në fotot e albumit shihen rroba të akuzuarve dhe motorri i të akuzuarit M. dhe një kaçavidë mjete me të cilin është kyryer vepra penale dhe prej të cilit lëndime ka pësuar i akuzuari L..

Gjendja faktike e veprave penale të kyryera nga të akuzuarit M. dhe Sh. vërtetohet pjesërisht edhe nga vetë të akuzuarit M. dhe Sh. nga mbrojtja e tyre, i akuzuari M. në një pyetje të parashtruar është përgjigjur se “edhe mund ta kem goditur të akuzuarin L.” ndërkaq i akuzuari Sh. në një pyetje është përgjigjur se “është e vërtet që e kam shtyrë të akuzuarin L. dhe i kam thënë ec, pra u plotësuan të gjitha elementët e veprës penale të lëndimet të lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin1 të KP –së vepër e kyryer nga i akuzuari M. dhe veprës penale sulmi nga neni 187 par 1 të kyryer nga i akuzuari Sh..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor mbrojtësi i të akuzuarit Sh. G. av. G. Gj. ka propozuar që në cilësinë e dëshmiarit për tu dëgjuar të ftohet një person me emrin Sh. pa mbiemër duke thënë se shënime të plota nuk kemi dhe adresat nuk ja dijmë ato do ti bëjmë me parshtrësë, si dhe të ftohet në cilësinë e mjekut ligjor dr. M. G.. Mbrojtësi i të akuzuarit M. G. av. B. Gj. ka propozuar që në cilësinë e dëshmitarit për tu dëgjuar të ftohet pronari i lokalit “Bajron” i cili gjindet në Prizren emrin e të cilit nuk ja dijm, gjykatës do tja parashrojmë me parshtrësë së veçantë, në rrethana se i njëjti mund të ketë parë diqka pasi që lokali gjendet afër shkollës.

Gjykata ka miratuar propozimin e mbrojtësit G. Gj. për dëgjimin e ekspertit mjekoligjor, ndërkaq ka refuzuar propozimet e mbrojtësve për dëgjimin e dëshmitarëve me emrin Sh. pa mbiemër dhe pronarin e lokalit “Bajron” nën rrethat se të njëjti mund ta kenë “*parë*” ngjarjen, pasi që gjykata ka vlerësuar se ky fakt në lidhje me atë se si ka ndodhur ngjarja përlëshja në mes të akuzuarve u vërtetua nga shiqimi i videonqizimeve në vendet publike në prani të të gjitha palëve dhe se vetë mbrojtësit ishin konfuz me identitetin e dëshmitarëve pasi që njëri prej tyre u tha pa mbiemër e tjetri vetëm si pronar i një lokali por ma emër dhe mbiemër, dhe kjo do të kishte për qëllim zhagitjen e procedurës.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KP-së, si rrethanë lehtësuese e vlerësoj: se kanë pasur sjelljet korrekte në seancë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata e vlerësoj vendin, kohën dhe mënyrën dhe rrethana se si është kyryer vepra penale, vendi ku të pandehurit kanë vepruar ne mënyrë te kundërligjshme, ngjarja ka ndodhur afër shkollës fillore “Abdyl Frashëri” në vendin ku frekUNETOHET nga shume njerëz, mjete me të cilin është kyryer vepra kaçavidë të njëjtit kanë raste të hapura në gjykatë, pra edhe pse gjykata ka konstatuar se ka pasur rrethana tejet rënduese në raport me të akuzuarit, i shqiptoi dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e

tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimet i shqiptuar janë në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprat penale për të akuzuarin.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga theksimet e theksuara me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1967/17, dt.08.10.2018

Procesmbajtësja
Shyhrete Sopaj

Gjyqtari
Mehmet Ndrecaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.